



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr.2004/42

PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE - SHKENCORE

Kuvendi i Kosovës

Në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Rregullorja Nr.2001/9 e datës 15 maj 2001, në pajtim me Kreun 5.1(d) , 9.1.26 (a) si dhe me qëllim që:

- veprimtaria kërkimore shkencore të avancohet me hulumtime të vazhdueshme të fushave të ndryshme shkencore;
- të avancohen të mirat e gjithëmbarshme materiale duke ngritur cilësinë e tyre në përputhje me zhvillimin e proceseve të reja;
- të krijohen kushtet dhe rregullat përkatëse në fusha të ndryshme të shkencës;
- rezultatet e kërkimeve shkencore të jenë të arritshme për bartësit e teknologjisë së re dhe që ato të prijnë dhe të ndikojnë në zhvillimin ekonomik-shoqëror të Kosovës;
- puna kërkimore-shkencore të funksionoj dhe të zhvillohet sipas standardeve të përgjithshme Europiane dhe ndërkombëtare.

Miraton:

LIGJIN PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE - SHKENCORE

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi
Neni 1

Me këtë ligj rregullohen: themelimi, veprimtaria, organizimi, qeverisja dhe suprimimi i personave juridikë publikë dhe private në fushën kërkimore-shkencore; të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve në këtë veprimtari; pozita e Këshillit Kombëtar Shkencor; miratimi dhe zbatimi i Programit Kombëtar Kërkimo-Shkencor; bazat e financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore; si dhe çështje të tjera lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore në Kosovë.

Neni 2

2.1. Veprimtaria kërkimoro-shkencore është veprimtari e interesit të veçantë publik e shtetëror, dhe është pjesë përbërse në hapësirën shkencore ndërkombëtare.

2.2. Veprimtaria kërkimoro-shkencore paraqet punën krijuese sistematike që ndërmerret me qëllim të kërkimit dhe zhvillimit të njohurive të reja, të shfrytëzimit dhe të zbatimit të tyre në praktikë.

2.3. Veprimtaria kërkimoro-shkencore përfshin veçanërisht kërkimet shkencore, kërkimet zhvillimore, publikimin e rezultateve të tyre, aftësimin e kuadrove për punë kërkimore-shkencore dhe zhvillimore, si dhe mirëmbajtjen dhe ndërtimin e infrastrukturës kërkimore-shkencore, që i ndihmojnë prosperitetit ekonomik të vendit .

Neni 3

3.1. Kërkimet shkencore përfshijnë kërkimet fundamentale, kërkimet aplikative dhe kërkimet zhvillimore.

3.2. Kërkimet fundamentale përfshijnë kërkimet e thelluera terike,eksperimentale ose të kombinuera që ndërmerren për arritjen e njohurive të reja ose për kërkimin e fushave të reja të hulumtimit me qëllim të qartësimit të dukurive dhe të modeleve fizike me interes afatëgjate të zbatimit të tyre.

3.3. Kërkimet aplikative paraqesin punën krijuese të mbështetur në rezultatet e kërkimeve fundamentale, e cila ndërmerret për zgjidhjen e çështjeve praktike të caktuara.

3.4. Kërkimet zhvillimore përfshijnë punën krijuese të mbështetur mbi rezultatet e kërkimeve bazë dhe të atyre aplikative, që ndërmerret me qëllim të aplikimit të proceseve të reja apo për përsosjen e atyre ekzistuese.

Neni 4

Aftësimi i kuadrit për punë kërkimore-shkencore ka të bëjë me përfshirjen në metodologjinë dhe në teknikën e punës kërkimore-shkencore të studentëve pasuniversitarë, për përgatitjen dhe për mbrojtjen e tezave të magjistraturave dhe të doktoratave, në përsosjen e mëtejshme shkencore brenda vendit dhe në botë.

Neni 5

Infrastruktura kërkimoro-shkencore përfshin sidomos: objektet, pajimet dhe shërbimet e nevojshme për veprimtarinë kërkimore-shkencore si laboratorët kërkimorë-shkencorë, bibliotekat shkencore, shërbimet informative shkencore, botimet shkencore etj.

Neni 6

Veprimtaria kërkimore-shkencore mbështetet në parimet:

- (a) e lirisë së kërkimeve shkencore dhe të krijimtarisë;
- (b) e punës publike;
- (c) e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale;
- (d) e konkurrencës së programeve dhe projekteve shkencore;
- (e) e pacënueshmërisë dhe të sigurisë së aftësive të njeriut dhe të dinjitetit të tij;
- (f) e etikës dhe të përgjegjësisë së punëtorit shkencor dhe të hulumtuesit për pasojat e punës së tij;
- (g) e kujdesit për mbrojtjen e ambientit të njeriut;
- (h) e ndërlidhjes së kërkimeve shkencore dhe të shkollimit të lartë;
- (i) e përfshirjes në veprimtarinë shkencore ndërkombëtare.

Neni 7

Për sigurimin e kushteve dhe mjeteve të nevojshme ndahen deri 0,7% e Buxhetit të Kosovës. Këto mjete shfrytëzohen për financimin e:

- (a) veprimtarisë së rregulltë kërkimore-shkencore;
- (b) zhvillimin dhe zgjerimin e rezultateve shkencore;
- (c) rritjen e vëllimit dhe të cilësisë së veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- (d) publikimin e të arriturave shkencore;
- (e) zbatimin e rezultateve të kërkimeve shkencore;
- (f) mbështetjen, përkrahjen dhe nxitjen e punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve, për tu marrë me punë kërkimore-shkencore.

Neni 8

Veprimtarinë kërkimore-shkencore e ushtrojnë personat juridikë publikë dhe privat të fushave kërkimore-shkencore, si dhe personat e tjerë juridikë të cilëve u është njohur statusi përkatës në pajtim me këtë ligj.

Neni 9

Punët kërkimore-shkencore i ushtrojnë punëtorët shkencorë dhe hulumtuesit që kanë tituj përkatës shkencorë dhe hulumtues, si dhe personat e tjerë në bazë të dispozitave e këtij ligji.

Neni 10

Mjetet për realizimin e Programit Kombëtar Kërkimor-Shkencor përcaktohen me Buxhetin e Kosovës.

KAPITULLI II

PERSONAT JURIDIKË PUBLIKË KËRKIMORË-SHKENCORË

1. Ushtrimi i veprimtarisë kërkimoro-shkencore

Neni 11

11.1. Veprimtarinë kërkimore-shkencore e ushtrojnë institucionet shkencore në cilësinë e personave juridikë kërkimorë-shkencorë.

11.2. Persona juridikë kërkimorë-shkencorë janë:

- (a) Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës,
- (b) Institutet kërkimore-shkencore, Instituti Albanologjik dhe Instituti i Historisë,
- (c) Universitetet.

11.3. Përsonat e tjerë juridikë mund të merren me veprimtari kërkimore-shkencore në qoftë se i përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe nëse marrin Licencën nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës.

2. Themelimi i institucioneve kërkimoro-shkencore

Neni 12

Institutet kërkimore-shkencore themelohen si institucione shkencore publike dhe private.

Neni 13

Institutet kërkimoro-shkencore janë institute të pavarura shkencore publike, kurse ato që formohen në kuadër të institucioneve të shkollimit të lartë janë institute kërkimoro-shkencore në përbërje të këtyre institucioneve.

Neni 14

Krahas punëve të përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji, me qëllim të bashkëpunimit sa më të mirë midis institucioneve kërkimoro-shkencore dhe të institucioneve të shkollimit të lartë, të ndërlidhjes së punës kërkimoro-shkencore me shkollimin e lartë, zhvillimi i një pjese të punëve praktike mund t'u besohet instituteve kërkimore-shkencore.

Neni 15

Institutin mund ta themelojnë personi juridik dhe personi fizik i vendit dhe i huaj në bazë të kushteve të parapara në nenin 21 të këtij ligji.

Neni 16

Për kryerjen e shërbimeve publike në fushën ose lëmin kërkimoro-shkencore, Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë themelon institute shkencore publike.

Neni 17

17.1. Instituti shkencor publik themelohet me ligj.

17.2 Instituti privat themelohet me vendimin e themeluesit, në pajtim me Ligjin.

Neni 18

Fakultetet, që janë në kuadër të universitetit, mund të themelojnë, në përbërje të tyre, institute apo njësi të tjera kërkimore- shkencore.

Neni 19

Institutet kërkimore-shkencore:

- (a) ushtrojnë veprimtarinë kërkimore-shkencore;
- (b) kujdesen për ngritjen e brezit të ri kërkimor-shkencor,
- (c) zhvillojnë bashkëpunim të ndërsjellë me interes të përbashkët për përparimin e punës kërkimore-shkencore dhe për aftësimin e kuadrit shkencor;
- (d) organizojnë dhe përparojnë veprimtarinë në fushën e publikimeve si dhe të informimit kërkimore-shkencor;
- (e) bashkëpunojnë me institucionet kërkimore-shkencore të vendit dhe të botës.

Neni 20

Këshilli Kombëtar i Shkencës nga neni 54 i këtij ligji jep mendimin për nevojën e themelimit të institutit publik dhe të atij privat.

Neni 21

21.1. Instituti kërkimoro shkencor mund të ushtrojë veprimtari kërkimoro-shkencore në qoftë se i përmbush këto kushte:

- (a) të ketë program afatgjatë të veprimtarisë kërkimoro-shkencore;
- (b) të ketë së paku 5 punëtorë shkencorë dhe hulumtues në marrëdhënie të përhershme pune për kohë të pacaktuar, prej të cilëve, së paku dy të kenë tituj shkencorë;
- (c) të ketë siguruar lokalin dhe pajisjet;
- (d) të ketë dokumentacion shkencor-informues;
- (e) të plotësojë edhe kushte të tjera të përcaktuara me ligj.

21.2. Në bazë të informatës së Ministrisë lidhur me kushtet nga paragrafi 1 e këtij neni, Këshilli Kombëtar i Shkencës jep mendimin për përmbushjen e standardeve për organizimin dhe për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

21.3. Këshilli Kombëtar i Shkencës është i detyruar që mendimin nga paragrafi.2. e këtij neni t'ia japë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë brenda afatit prej dy muajsh nga dorëzimi i informatës.

Neni 22

22.1. Në rrethana të jashtëzakonshme të okupimit, të rrezikimit të drejtpërdrejtë nga lufta ose të gjendjes së luftës, puna dhe veprimtaria e instituteve shkencore mund të zhvillohet edhe në kushte të tjera nga paragrafi 1 i nenit 21 të këtij Ligji.

22.2. Ministria i përcakton më hollësisht kushtet nga paragrafi.1 i këtij neni.

Neni 23

23.1. Instituteve shkencore, që i plotësojnë kushtet nga paragrafi.1 e nenit 21 të këtij ligji, Ministria ua jep lejen për fillimin dhe vazhdimin e veprimtarisë dhe i regjistron në Regjistrin e instituteve kërkimoro-shkencore.

23.2. Procedurën e regjistrimit në Regjistër e përcakton Ministria.

Neni 24

Institetet private që kanë marrë leje për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë, duhet t'ia bashkangjesin detyrimisht emrit të vet edhe shenjën “me të drejtë publike”.

Neni 25

Institetet shkencore publike dhe private mund të fillojnë ushtrimin e veprimtarisë së tyre që nga momenti i regjistrimit .

3. Organizimi dhe qeverisja

Neni 26

26.1 Organizimi i brendëshëm i institutit në pajtim me ligjin përcaktohet me statut.

26.2. Masat për qeverisjen dhe administrimin e Institucionit kërkimoro shkencor përcaktohen me statut të miratuar nga këshilli drejtues me pëlqimin paraprak të Ministrisë.

26.3 Statuti që i paraqitet Ministrisë në bazë të dispozitave të këtij ligji, miratohet nëse i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligj. Refuzimi i Ministrisë për të miratuar një statut për të bërë modifikime në të mund të kundërshtohet përmes ankesës të parashtruar në Qeveri.

Neni 27

Organet e qeverisjes së Institutit janë:

- a. këshilli drejtues,
- b. drejtori.

Këshilli drejtues Neni 28

28.1. Këshilli drejtues është organ kolegjal i qeverisjes së institutit. Këshillin e përbëjnë udhëheqësit e njësisë të veçanta të institutit, me të udhëheq drejtori i Institutit.

28.2. Numri i anëtarëve, përbërja dhe kompetencat e këshillit drejtues më përifer përcaktohen me statutin e institutit publik.

28.3. Nxjerrë statutin dhe aktet për organizimin e punës dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

Këshilli shkencor Neni 29

29.1. Këshilli shkencor është organ profesional i institutit që :

- (a) shqyrton dhe vendos për çështjet shkencore dhe profesionale;
- (b) propozon kandidatët për drejtor të institutit;
- (c) zhvillon procedurën e zgjedhjes në titujt shkencorë dhe në ata hulumtues;
- (d) kryen edhe punë të tjera në pajtim me statutin e institutit dhe me vendimin për themelimin e tij.

29.2. Numri i anëtarëve, përbërja dhe kompetencat e këshillit shkencor përcaktohen më për së afërmi me statut.

29.3. Anëtarë të këshillit shkencor mund të zgjidhen edhe punëtorë shkencorë të cilët nuk janë të punësuar në institut, por janë të angazhuar në realizimin e projekteve shkencore. Mënyra e zgjedhjes së tyre përcaktohet me statut.

29.4. Me statut të institutit mund të përcaktohet se kush mund ta ushtrojë detyrën e kryetarit të këshillit shkencor të institutit.

Drejtori Neni 30

30.1. Drejtori është organ individual i qeverisjes së institutit.

30.2. Drejtor i institutit mund të zgjedhet personi që i përmbush kushtet për t'u zgjedhur, së paku bashkëpunëtor i lartë shkencor.

30.3. Drejtori i institutit publik zgjedhet në bazë të konkursit publik të cilin e shpallë këshilli shkencor.

30.4. Këshilli Shkencor në marrëveshje me Ministrin emëron Komisionin profesional – shkencor për zbatimin e procedurës së zgjedhjes të drejtorit. Komisioni ka për detyrë të konstatojë se cilët prej kandidatëve që kanë konkurruar i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta, në pajtim me ligjin dhe me statutin e institutit.

30.5. Komisioni përbëhet prej së paku pesë anëtarësh, prej të cilëve tre anëtarë emërohen nga radha e punonjësve shkencorë të institutit, ndërkaq dy anëtarë i emëron Ministria.

30.6. Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, i paraqet këshillit shkencor të institutit vlerësimin shkencor e profesional për secilin kandidat të paraqitur, si dhe jep propozimin e vet se cilët prej tyre i plotësojnë më së miri kushtet për tu zgjedhur drejtor i institutit.

30.7. Në mbështetje të këtij vlerësimi, këshilli shkencor i institutit i propozon Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, kandidatët për drejtor të institutit.

30.8. Drejtorin e institutit zgjedh dhe e shkarkon Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, në bazë të propozimit të këshillit drejtues të institutit.

30.9. Drejtorin e institutit që vepron në kuadër të Institucioneve të shkollimit të lartë, sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar me statut, e emëron dhe e shkarkon themeluesi.

30.10. Mandati i drejtorit caktohet në pajtim me Ligjin mbi Shërbimin Civil.

Neni 31

31.1. Drejtori e udhëheq dhe e përfaqëson institutin dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së institutit.

31.2. Drejtori e kryeson këshillin shkencor, në qoftë se kështu është përcaktuar me statutin e institutit.

31.3. Përveç punëve nga paragrafi 1 dhe 2 e këtij neni, drejtori veçanërisht:

- (a) organizon punën dhe veprimtarinë e institutit;
- (b) nxjerr aktin për sistematizimin e vendeve të punës sipas propozimit të këshillit shkencor;
- (c) nënshkruan kontratat e punës me punëtorët e institutit;
- (d) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin e institutit.

Neni 32

32.1. Drejtori për punën e vet, i përgjigjet këshillit drejtues dhe MASHT-it, në pajtim me dispozitat e këtij Ligji dhe dispozitat e Statutit të Institutit.

32.2. Drejtori, së paku një herë në vit, i paraqet këshillit shkencor të institutit raport për punën e tij dhe veprimtarinë e institutit.

Neni 33

Dispozitat e këtij ligji për udhëheqjen e instituteve publike zbatohen edhe në udhëheqjen e instituteve private, përveç dispozitave për mënyrën e zgjedhjes, të përbërjes dhe të mandatit të organeve drejtuese dhe të udhëheqësve.

Neni 34

Në këshillin drejtues të instituteve publike, Ministria emëron një të tretën e anëtarëve të këtyre organeve.

4. Humbja e statusit përkatës kërkimor-shkencor të institutit ose të personit tjetër juridik

Neni 35

35.1. Në qoftë se Ministria konstaton se instituti ose personi tjetër juridik nuk i përmbush kushtet nga neni 21 i këtij ligji brenda afatit një vjeçar do të fillojë dhe do të zbatojë procedurën për shlyerjen nga Regjistri, pra për humbjen e statusit përkatës kërkimor-shkencor të institutit ose personit tjetër juridik.

35.2. Në procedurën e shlyerjes nga Regjistri zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat si për regjistrimin në Regjistrin përkatës.

35.3. Kundër vendimit për shlyerjen nga Regjistri, ankesa i paraqitet Qeverisë.

35.4. Lidhur me vendimin për shlyerjen nga Regjistri, Ministria i njofton themeluesin dhe organet e tjera për zbatimin e procedurave përkatëse.

KAPITULLI III

PUNËTORËT SHKENCORË DHE HULUMTUESIT

Neni 36

36.1. Në institucionet shkencore nga neni 11 i këtij ligji, punë kërkimore-shkencore e ushtrojnë punëtorët shkencorë me tituj shkencorë sipas dispozitave të këtij ligji.

36.2. Me punë kërkimore-shkencore, krahas punëtorëve shkencorë, merren edhe hulumtuesit, që sipas dispozitave të këtij ligji, i përmbushin kushtet për t'u zgjedhur në tituj hulumtues.

36.3. Përveç punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, punë kërkimore-shkencore në universitet dhe në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, sipas dispozitave të ligjit të veçantë, e ushtrojnë edhe mësimdhënësit e zgjedhur në tituj shkencorë-mësimorë.

1. Titujt shkencorë dhe hulumtues Neni 37

37.1. Titujt shkencorë: bashkëpunëtor shkencor, bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe këshilltar shkencor, janë të barazvlershëm me thirrjet mësimore-shkencore që janë në univerzitet.

37.2. Titujt hulumtues janë: hulumtues dhe hulumtues i pavarur.

37.3. Titulli bashkëpunëtor shkencor –është i barazvlershëm me titullin shkencoro-mësimor asistent profesor; titulli bashkëpunëtor i lartë shkencor është i barazvlershëm me titullin shkencoro-mësimor profesor inordinar, titulli këshilltar shkencor është i barazvlershëm me titullin shkencoro-mësimor profesor i regullt.

37.4. Titulli hulumtues është i barazvlershëm me titullin asistent i ri; titulli hulumtues i pavarur është i barazvlershëm me titullin asistent.

2. Zgjedhja në titujt shkencorë dhe hulumtues Neni 38

38.1. Bashkëpunëtor shkencor, në kohëzgjatje prej pesë vjetësh, mund të zgjedhet personi që ka shkallën e doktorit të shkencave, që ka botuar së paku një vepër shkencore, si dhe ka botuar punime shkencore në revista dhe në publikime të njohura brenda vendit dhe në botë.

38.2. Bashkëpunëtor i lartë shkencor, në kohëzgjatje prej pesë vjetësh zgjedhet personi i cili ka arritur shkallën shkencore të doktorit të shkencave, që ka botuar së paku dy vepra shkencore, një prej tyre pas zgjedhjes së fundit, që ka publikuar punime të rëndësishme shkencore në revista dhe në publikime të njohura brenda vendit dhe në botë, si dhe që ka punime të reja shkencore të publikuara pas zgjedhjes në titullin e mëparshëm.

38.3. Këshilltar shkencor zgjedhet personi i cili ka marrë titullin doktor i shkencave, që ka botuar së paku tri vepra shkencore, një prej tyre pas zgjedhjes së fundit, që ka një numër të madh punimesh shkencore në revista e publikime të njohura brenda vendit dhe në botë, që kanë ndikuar dukshëm në zhvillimin e mendimit shkencor në fushën përkatëse dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë shkencore, si dhe të ketë punime të reja të publikuara pas zgjedhjes në titullin e mëparshëm.

38.4. Titulli këshilltar shkencor është i përhershëm.

Neni 39

39.1. Hulumtues, në kohëzgjatje prej tri vjetësh, zgjedhet personi me studime përkatëse themelore me notë mesatare mbi tetë dhe që ka regjistruar studimet pasuniversitare shkencore, ose studimet e larta artistike universitare, që nuk ka më shumë se 27 vjet dhe që ka publikuar punime profesionale ose shkencore.

39.2. Hulumtues i pavarur, në kohëzgjatje prej tri vjetësh, zgjedhet personi me shkallë akademike të magjistratit të shkencave dhe që ka punime të publikuara në revista shkencore.

39.3. Hulumtuesit nga paragrafi 1 e këtij neni mund të zgjedhen në titullin e njëjtë edhe një herë.

Neni 40

40.1. Punëtorët shkencorë dhe hulumtuesit zgjedhen vetëm në titullin vijues shkencor ose hulumtues pa i kapërcyer titujt shkencorë ose hulumtues.

40.2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 e këtij neni, kapërcimi i titujve shkencorë dhe hulumtues mund të bëhet në raste të jashtëzakonshme dhe për rezultate shkencore të jashtëzakonshme.

40.3. Me statut të institutit përcaktohen se cilat rezultate të arritura shkencore konsiderohen të jashtëzakonshme, si dhe procedura e zgjedhjes me këtë rast.

Neni 41

Zgjedhja e punëtorëve shkencorë dhe e hulumtuesve bëhet në bazë të konkursit publik.

Neni 42

42.1. Mendimin se kandidati i përmbush kushtet për zgjedhje në titullin shkencor ose në titullin hulumtues, e jep komisioni recensues i emëruar nga këshilli shkencor i institutit, i cili zbaton procedurën e konkursit.

42.2. Komisioni recensues profesional, paragrafi 1 e këtij neni, përbëhet, së paku, prej tre anëtarëve, dy prej të cileve duhet të jene nga lëmi i ngusht profesional që nuk bën të jenë me tituj më të ulët së titulli për të cilin e shkruajnë recensionin.

Neni 43

43.1. Referati i komisionit recensues përmban: shënimet biografike dhe bibliografike të kandidatit, vlerësimin e punës së tij shkencore, si dhe propozimin për zgjedhje.

43.2. Referati nga paragrafi 1 e këtij neni jepet në diskutim publik sipas mënyrës së përcaktuar me aktin e institutit, e më së paku tridhjetë ditë para marrjes së vendimit.

Neni 44

44.1. Këshilli shkencor i institutit, që zbaton procedurën në bazë të mendimit të komisionit recensues, merrë vendim për zgjedhjen e të propozuarit në titullin përkatës shkencor ose hulumtues.

44.2. Procedura e zgjedhjes sipas konkursit duhet të përfundojë brenda afatit prej gjashtë muajsh.

Neni 45

Me statutin e institutit e në pajtim me dispozitat e këtij ligji përcaktohet më përfaqësimi i procedurës së zgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve.

Neni 46

46.1. Punime shkencore konsiderohen vetëm ato punime që janë të botuara në revista e publikime shkencore të cilat i përmbushin kriteret ndërkombëtare shkencore dhe që janë të regjistruara në indekset ndërkombëtare..

46.2. Ministria, në bazë të propozimit të këshilli të shkencave përkatëse do të përcaktojë me dispozita të veçanta bazat e vlerësimit dhe regjistrin e revistave dhe të publikimeve të cilat i përmbushin kriteret ndërkombëtare shkencore.

3.Mbajtja e regjistrit të punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve

Neni 47

47.1. Regjistrin e punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve e mban Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.

47.2. Në Regjistër, nga paragrafi 1 e këtij neni, përveç punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, regjistrohen edhe personat e zgjedhur me tituj shkencorë-mësimorë e që marrin pjesë në realizimin e projekteve kërkimore-shkencore dhe të projekteve të tjera.

47.3. Ministria, nga paragrafi 1 e këtij neni, përcakton përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit, si dhe procedurën e regjistrimit dhe të shlyrjes nga Regjistri.

4.Lidhja dhe shkëputja e marrëdhënies së punë

Neni 48

Punëtorët shkencorë dhe hulumtuesit lidhin me institutin, ose me personin tjetër juridik kërkimor-shkencor, kontratën për punën në pajtim me Ligjin mbi Shërbimin Civil.

Neni 49

Kontrata e punës e lidhur midis puntorit dhe institutit apo personit tjetër juridik kërkimor-shkencor e prishin:

- (a) në qoftë se punëtori shkencor ose hulumtuesi e humb statusin e punëtorit shkencor, për shkak se nuk zgjedhet në titullin e paraparë;
- (b) në qoftë se në bazë të konkursit publik zgjidhet personi tjetër;
- (c) me kërkesën e punëtorit shkencor ose të hulumtuesit;
- (d) në qoftë se punëtori i shkelë rendë detyrat e punës, ose që me sjelljet e tij e ulë autoritetin e institutit;
- (e) në rastet e tjera të përcaktuara me ligj.

5.Aftësimi dhe përsosja kërkimore shkencore
Neni 50

50.1. Me qëllim që të rinjtë të përgatiten, të aftësohen dhe të përfshihen në punën kërkimore-shkencore, në institut bën të pranohen praktikantët.

50.2. Praktikant bën të zgjidhet personi me studime përkatëse themelore, me notë mesatare mbi tetë, dhe që nuk ka më shumë se 27 vjet.

50.3. Praktikanti zgjidhet në kohëzgjatje prej tri vjetësh.

50.4. Me statut të institutit përcaktohen kushtet për zgjedhjen e praktikantit-stazhier.

50.5. Ministria do të përcaktojë rregulla të veçanta për aftësimin dhe përsosjen shkencore të praktikantëve-stazhierëve, të studentëve të studimeve pasuniversare dhe inkuadrimit të tyre në punën kërkimore-shkencore, (dhënien e bursave, për mënyrën e krijimit të marrëdhënies së punës punës me magjistrantët dhe me doktorantët gjatë kohës së përgatitjes së magjistratureve ose të doktoratave e që janë të angazhuar në projektet shkencore, etj.).

KAPITULLI IV

PROGRAMI KOMBËTAR KËRKIMOR-SHKENCOR

Neni 51

Me Programin Kombëtar Kërkimoro-Shkencor përcaktohen:

- (a) fushat shkencore që duhet të zhvillohen në mënyrë të veçantë;
- (b) fushat shkencore, që duhet të zhvillohen në mënyrë sistemore, për shkak të ngecjes në zhvillim;
- (c) përparësitë ne veprimtarinë kërkimore-shkencore;
- (d) përparësitë e investimeve të personave juridikë kërkimorë-shkencore;
- (e) programin e pjesëmarrjes në projektet kërkimore-shkencore ndërkombëtare;
- (f) programin e blerjes dhe të shfrytëzimit të pajisjeve;
- (g) programin e arsimit sistematik të punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve;
- (h) programin e zhvillimit të informacionit shkencor dhe të publikimit të rezultateve të arritura të punës kërkimore-shkencore;
- (i) mjetet e nevojshme për realizimin e Programit Kombëtar Kërkimor-Shkencor.

Neni 52

52.1. Programin Kombëtar Kërkimoro-Shkencor, i cili bazohet në vlerësimin profesional e shkencor të gjendjes së kërkimeve shkencore në Kosovë, të nevojave dhe të mundësive reale për realizimin e tij, e miraton Kuvendi i Kosovës, në bazë të propozimit të Qeverisë së Kosovës.

52.2. Programi Kombëtar Kërkimoro-Shkencor miratohet për periudhën pesëvjeçare, ndërkaq plotësohet dhe ndrysohet me procedurë të njëjtë.

52.3. Qeveria e Kosovës, i paraqet çdo dy vjet, Kuvendit të Kosovës raport për zbatimin e Programit Kombëtar Kërkimor-Shkencor, si dhe për gjendjen e përgjethshme në veprimtarinë kërkimoro-shkencore në Kosovë.

52.4. Mjetet për realizimin e Programit Kombëtar Kërkimoro-Shkencor sipas propozimit të qeverisë i përcakton Kuvendi i Kosovës.

KAPITULLI V

KËSHILLI KOMBËTAR I SHKENCËS

Neni 53

Këshilli Kombëtar i Shkencës themelohet me detyrë të përkujdesjes e zhvillimit e veprimtarisë kërkimore-shkencore të Kosovës.

Neni 54

Këshilli Kombëtar Shkencor :

- (a) i paraqet Qeverisë së Kosovës propozimin e Programit Kombëtar-Shkencor;
- (b) vlerëson në aspektin krahasimtar gjendjen në veprimtarinë kërkimore-shkencore, pozitën dhe zhvillimin e saj në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare;
- (c) jep mendimin për nevojën e themelimit të instituteve kërkimore-shkencore;
- (d) propozon dhe nxit ndërmarrjen e masave për përparimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- (e) shqyrton dhe jep mendimin për çështje të tjera të rëndësishme për zhvillimin e gjithmbarshëm të Kosovës, sipas kërkesës së Kuvendit të Kosovës.

Neni 55

55.1. Këshilli Kombëtar i Shkencës ka 15 anëtarë.

55.2. Kryetar i Këshillit Kombëtar të Shkencës zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

55.3. Anëtarët e tjerë të Këshillit Kombëtar të Shkencës i emëron Kuvendi i Kosovës, në bazë të propozimit të Qeverisë së Kosovës, me mandat prej 4 vjetësh .

Neni 56

56.1. Instrukcionet shkencore të Kosovës i propozojnë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës.

56.2. Instrukcionet të cilat japin propozimet për anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës, duhet të prezantojnë veprimtarinë e përgjithsme shkencore dhe profesionale për secilin kandidat të propozuar.

56.3. Me rekomandim të Ministrisë Qeveria bën listen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Shkencës, duke pasur parasysh përfaqësimin e të gjitha fushave shkencore si dhe autoritetin shkencor e profesional të secilit kandidat.

56.4. Ministria mund t'i propozojë Qeverisë së Kosovës edhe ndonjë kandidat tjetër që nuk është propozuar nga instrukcionet shkencore të Kosovës, në pajtim me paragrafin 1 dhe 3 të këtij neni.

Neni 57

57.1. Anëtari i Këshillit Kombëtar i Shkencës mund të shkarkohet para skadimit të mandatit, në këto raste:

- (a) me kërkesën e vet anëtarit
- (b) nëse nuk i përmbush detyrimet e anëtarit
- (c) nëse e humb aftësinë e ushtrimit të detyrave
- (d) nëse me sjelljet e ti e cenon dinjitetin e funksionit të cilin e kryen.

57.2. Kërkesën për shkarkim të anëtarit mund ta bëjë kryetari ose së paku pesë anëtarë të Këshillit.

57.3. Pas marrjes së kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni, Këshilli formon një komision nga radhët e anëtarëve të vet, dhe në bazë të raportit të këtij komisioni, Kuvendi i Kosovës do të merr vendim për shkarkimin ose mos shkarkimin e anëtarit të Këshillit.

Këshilli Shkencor

Neni 58

58.1. Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë / Qeverija formon Këshillin Shkencor dhe këshillat për fusha përkatëse shkencore, me qëllim të zbatimit të Programit Kombëtar Kërkimor-Shkencor.

- (a) Këshilli shkencor vlerëson suksesin e zbatimit të projekteve kërkimore-shkencore;
- (b) orienton zhvillimin e fushave shkencore në pajtim me orientimet e përcaktuara me Programin Kombëtar Kërkimor-Shkencor;
- (c) ndihmon hartimin e planit vjetor financiar;
- (d) propozon shpërndarjen e mjeteve për veprimtarinë kërkimore-shkencore nga buxheti i shtetit;

58.2. Anëtarët e Këshillit të Shkencës i emëron Ministria nga radhët e punëtorëve të njohur shkencorë, duke pasur parasysh përfaqësimin përkatës të fushave shkencore.

Neni 59

59.1. Ministria formon këshillat e fushave shkencore, (shkencave humanitare, shkencave të natyrës, shkencave të mjekësisë etj), anëtarët e të cilave emërohen për katër vjet.

59.2. Këshillat e fushave shkencore:

- (a) bëjnë vlerësimin profesional të projekteve,
- (b) propozojnë shpërndarjen e mjeteve për projekte.
- (c) japin mendimin për plotësimin e kriterëve minimale shkencore në procedurën e zgjedhjes së punëtorëve shkencorë.

59.3. Fushat shkencore i përcakton ministri, në bazë të propozimit të Këshillit Shkencor të Ministrisë.

Neni 60

60.1. Për projekte përkatëse Ministria shpall konkurs.

60.2. Projektet mund të paraqiten si:

- (a) projekte kërkimore-shkencore,
- (b) projekte zhvillimore,
- (c) projekte të zhvillimit të infrastrukturës.

Neni 61

61.1. Projektet i paraqesin institucionet shkencore sipas paragrafit 2 të nenit 11 të këtij ligji, ose punëtorët shkencorë, duke pasur pëlqimin edhe të institucionit ku projekti do të realizohet.

61.2. Realizues të projektit mund të jenë punëtorët shkencorë nga neni 36, paragrafi. 1., 2 e. 3, të këtij ligji.

61.3. Realizues të projektit mund të jenë edhe personat që nuk janë të punësuar në insticuionin shkencor që e realizon projektin.

Neni 62

Kriteret e përgjithshme për pranimin dhe vlerësimin e projektit janë:

- (a) rëndësia e projektit për zhvillimin e Kosovës,
- (b) vlera shkencore dhe përmasat ndërkombëtare të projektit,
- (c) arritjet shkencore, të njohura në shkallë ndërkombëtare, të bartësit të projektit,
- (d) racionaliteti i organizimit dhe i realizimit të projektit,
- (e) përshtashmëria ekologjike e projektit.

Neni 63

63.1. Në bazë të vlerësimit të projektit, Ministria merr vendim për pranimin e projektit dhe cakton bartësin përgjegjës të projektit.

63.2. Vendimi i Ministrisë për miratimin e projektit është i formës së prerë.

Neni 64

64.1. Udhëheqës përgjegjës i projektit kërkimoro-shkencor mund të jetë personi:

- (a) që është doktor i shkencave,
- (b) që ka punime shkencore të publikuara që dëshmojnë aftësinë për realizimin e projektit.

64.2. Udhëheqës përgjegjës të projekteve të tjera nga neni 58, paragrafi 1, 2. pika a ,b ,c d të këtij ligji, mund të jenë edhe ekspertët që nuk i plotësojnë kushtet nga paragrafi 1, pika (a) dhe (b) e këtij neni, por që punojnë në punët hulumtuese dhe zhvillimore, që kanë të regjistruar patentë dhe inovacione, ose që kanë përvojë të mjaftueshme në shfrytëzimin e infrastrukturës ekzistuese ose në instalimin e infrastrukturës së re.

Neni 65

65.1. Për realizimin e projektit Ministria lidhë kontratën me udhëheqësin përgjegjës të projektit, si dhe me institucionin kërkimor-shkencor ku punon udhëheqësi i projektit.

65.2. Elementet përmbajtësore të kontratës i cakton Ministria.

KAPITULLI VII

FINANCIMI

Neni 66

Mjetet për kryerjen veprimtaris kërkimore-shkencore të institucioneve sigurohen:

- (a) nga Buxheti i Kosovës të destinuara për punën e insitucioneve dhe për veprimtarinë kërkimore-shkencore;
- (b) nga fondet, fondacionet dhe donacionet;
- (c) nga mjetet që i realizon insitucioni kërkimor-shkencor;
- (d) Nga burimet tjera të ligjshme.

Neni 67

Mjetet nga neni 66, 1 pika a,b dhe c, të këtij ligji, shfrytëzohen:

- (a) për realizimin e projekteve kërkimore-shkencore, projekteve zhvillimore dhe ndërtimin e infrastrukturës;

- (b) për pagat dhe kompensimet për punëtorët shkencorë, hulumtuesit, personelin udhëheqës, personelin profesional, teknik dhe ndihmës të institucioneve;
- (c) për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe ruajtjen e materialeve shkencore-kërkimore;
- (d) nga burimet tjera të ligjshme;
- (e) për shpenzimet për bursa, ngritjen profesionale, ndihmat dhe për përfshirjen e studentëve dhe të praktikantëve në punën kërkimore-shkencore;
- (f) për marrëdhëniet ndërkombëtare shkencore;
- (g) për botimin e rezultateve kërkimore-shkencore (monografitë, revistat, përmbledhjet e punimeve etj.);
- (h) për blerjen e revistave shkencore dhe të publikimeve të tjera nga bota;
- (i) për organizimin e tubimeve shkencore;
- (j) për aktivitete të tjera shkencore.

Neni 68

68.1. Ministria formon Komisionin Financiar, si organ këshilldhënës për ndihmë materiale të institucioneve kërkimore-shkencore.

68.2. Ministria mund të nxjerr Rregullore të veçant për mënyren e financimit të institucioneve kërkimore-shkencore.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 69

69.1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji pushojnë punën institutet e formuara në bazë të Gazetës Zyrtare të KSAK nr.24/78 dhe të Dekretligjit të Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore të Kosovës të datës 17.04.1998.

69.2. Institucionet shkencore, të themeluara me ligje të veçanta, vazhdojnë punën si institucione shkencore publike të pavarura:

- (a) Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës
- (b) Instituti i Historisë
- (c) Instituti Albanologjik i Prishtinës

Neni 70

70.1. Personat juridikë nga neni 69.2 i këtij ligji, janë të detyruar të harmonizojnë statutet e tyre me këtë ligj brenda afatit prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

70.2. Deri në nxjerrjen e statuteve nga paragrafi 1 e këtij neni, insitucionet kërkimore shkencore i zbatojnë aktet e tyre të përgjithshme në fuqi, nëse me këtë ligj, nuk janë në kundërshtim.

Neni 71

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të dispozitave të nxjerra në bazë të tij e bën Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës.

Neni 72

72.1. Këshilli Kombëtar i Shkencës emërohet brenda afatit prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

72.2. Këshilli Kombëtar i Shkencës ka për detyrë që, brenda afatit njëvjeçar nga dita e emërimit, të zhvillojë procedurën e vlerësimit të gjendjes në institutet ekzistuese dhe në bazë të vlerësimit të tij me rekomandim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, Qeveria do t'i propozojë Kuvendit të Kosovës që të marrë vendim për transformimin e instituteve, si dhe për suprimimin e instituteve që nuk i plotësojnë kushtet e këtij ligji.

Neni 73

Anëtarët e Këshillit Shkencor të Ministrisë dhe të këshillave të fushave shkencore i emëron Ministria brenda afatit prej tre muajsh.

Neni 74

Ministria, brenda afatit prej tre muajsh, pas miratimit të këtij ligji, do të përcaktojë bazat e vlerësimit dhe regjistrin e revistave dhe të publikimeve të cilat i përmbushin kriteret ndërkombëtare shkencore.

Neni 75

75.1. Instucionet shkencore janë të obliguara që brenda një viti pas miratimit të këtij ligji t'i harmonizojnë titujt shkencorë dhe hulumtues me kriteret e përcaktuara me këtë ligj dhe me dispozitat e tjera të përcaktuara nga Ministria.

75.2. Punëtorët shkencorë dhe hulumtuesit të cilët janë mbi moshën 60 vjeçare, e mbajnë titullin e fituar, pavarisht se a i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 76

Procedura e zgjedhjes në titullin shkencor, që ka filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundon sipas procedurës së përcaktuar me dispozitat e mëparshme, por mund të përfundon edhe konform këtij ligji .

Neni 77

Punëtorët shkencorë dhe hulumtuesit e zgjedhur në titujt kërkimo-shkencorë rizgjedhën sipas dispozitave të këtij ligji, por jo para së të kalojë afati për të cilin janë zgjedhur sipas dispozitave të mëhershme.

Neni 78

Ministria do të nxjerrë dispozita brenda afatit prej tre muajsh për zbatimin e këtij ligji.

Neni 79

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji ,pushojnë së vepruari të gjitha dispozitat ligjore të cilat kanë të bëjnë me veprimtarin kërkimore shkencore si dhe Dekretligjin mbi Veprimtarin Kërkimoro Shkencore të Kosovës të dates 17.04.1998.

Neni 80

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Ligji Nr.2004/42
27 shtator 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci